REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT**

Nr.1053 prot. Tiranë, më, 17.07.2024

**VENDIM**

**Nr.3, datë 15.7.2024**

**PËR**

**"MIRATIMIN E PROJEKTPLANIT PËRFUNDIMAR TË MENAXHIMIT TË RREZIKUT NGA PËRMBYTJET PËR DISA ZONA KU EKZISTON RREZIKU POTENCIAL NGA PËRMBYTJET OSE KA GJASA TË NDODHIN PËRMBYTJE, DRIN-BUNË 4, 5 DHE 6 (TERRITORI I NJËSIVE ADMINISTRATIVE SHKODËR, ANA E MALIT, BËRDICË, DAJÇ, GURI I ZI, RRETHINAT DHE VELIPOJË TË BASHKISË SHKODËR DHE NJËSINË ADMINISTRATIVE BUSHAT TË BASHKISË VAU I DEJËS)"**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 70, të ligjit nr.111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar, të Kreut 3, të Shtojcës III, të vendimit nr.1015, datë 16.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të burimeve ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet", paragrafit "vii", të shkronjës "b", të pikës 1, të kreut III, të vendimit nr.221, datë 26.4.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Kombëtar i Ujit

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Projektplanit përfundimtar të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet për disa zona ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhin përmbytje, Drin-Bunë 4, 5 dhe 6 (territori i njësive administrative Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Rrethinat dhe Velipojë të bashkisë Shkodër dhe njësinë administrative Bushat të bashkisë Vau i Dejës), sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, pas procesit të bashkërendimit, të paraqesë për miratim në Këshillin e Ministrave, Planin përfundimtar të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbytjet për disa zona ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhin përmbytje, Drin-Bunë 4, 5 dhe 6 (territori i njësive administrative Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Rrethinat dhe Velipojë të bashkisë Shkodër dhe njësinë administrative Bushat të bashkisë Vau i Dejës).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**BELINDA BALLUKU**

**AGJENCIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE**
**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**GERTA LUBONJA**